




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



PËR: Znj. Njomëza Kupa, gjyqtare porote në Gjykatën Themelore në Gjakovë

NGA: Muhamet Rexha, Kryetar i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore

LËNDA: Përgjigje

DATA: 25.09.2023

E nderuar znj. Kupa,

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, (me tutje si KKEGJ), me datë 28 gusht 2023, ka pranuar kërkesën tuaj me të cilën keni kërkuar opinion me qëllim që të informoheni se a përbënë konflikt interesi në rastet kur një familjar (djali i dajës) është i punësuar në pozitën e zyrtarit ligjor apo të procesmbajtësit të një gjyqtar, dhe në seancat gjyqësore kur duhet të merrni pjesë, ndërsa për shkak të kësaj rrethane gjyqtarja e çështjes përkatëse ju ka mohuar të drejtën që të merrni pjesë juve si gjyqtare porote, në të gjitha rastet ku është prezent familjari juaj.

Bazuar në nenin 1, 7 dhe 9, të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, KKEGJ ka shqyrtuar kërkesën tuaj në takimin e mbajtur me datë 19 shtator 2023.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, KKEGJ ka ardhur në përfundim se lidhur me çështjen etike të ngritur nga ana juaj nuk është e nevojshme të nxjerrët opinion këshillëdhënës, pasi që rastet e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi i një çështje në gjykatë (përfshirë edhe gjyqtarët porotë) janë përcaktuar shprehimisht në dispozitën e nenin 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, por edhe në rregullat e Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar (i zbatueshëm edhe për gjyqtarët porotë).

Në lidhje me këtë, referuar rastiit tuaj, Komiteti vlerëson se pjesëmarrja juaj në trupin gjykues, ku zyrtar ligjor (apo procesmbajtës) i kryetarit të trupit gjykues është familjar i juaj (djali i dajës), në parim nuk paraqet konflikt interesi. Kjo për faktin se në rastin konkret familjari juaj

nuk rezulton të ketë pozitë vendimmarrëse, nuk është pjesë e trupit gjykues, përkatësisht i njëjti nuk e ka pozitën e palës, të autorizuarit apo përfaqësuesit ligjor, për çka edhe parimisht nuk mund të vlerësohet se kemi të bëjmë me konflikt interesi siç është përcaktuar me rregullat ligjore të LPK-së dhe ato të Kodit të Etikës. Megjithatë, është vlerësim i Komitetit se në përputhje me detyrimet që dalin nga dispozitat ligjore të LPK-së dhe rregullat e Kodit të Etikës për gjyqtarë, këshilloheni që në të gjitha rastet e pjesëmarrjes suaj në trup gjykues ku në zyrën e kryetarit të trupit gjykues punon familjari juaj, përmes kryetarit jeni e obliguar që të informoni palët ndërgjyqëse për këtë rrethanë (*ndërsa ky informim të shënohet në procesverbal*), në mënyrë që palëve ti jepet mundësia e parashtrimit të kërkesës për përjashtimin tuaj nga gjykimi, nëse e vlerësojnë se në rastin e tillë ka konflikt interesi, apo dyshojnë në kryerjen e detyrave tuaja si gjyqtare porote me objektivitet dhe paanësi. Përveç legjislacionit të lartë cekur, ju si gjyqtare porote në bazë të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, obligoheni që të kërkonti përjashtimin tuaj nëse vlerësoni se te publiku mund të krijohet përshtypja, ose kur e vlerësoni vet, se nuk jeni në gjendje të vendosni në lidhje me lëndë në mënyrë të paanshme, përkatësisht në të gjitha rastet kur plotësohen kushtet ligjore nga neni 67 i LPK-së, por edhe ato të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtarë.

Në anën tjetër, nga fakti se ju keni pozitë vendimmarrëse, përkatësisht jeni pjesë e trupit gjykues në çështjet gjyqësore (lëndët statusore) dhe me qëllim të mbarëvajtjes së punës në gjykatë, është e këshillueshme që në lëndët ku angazhoheni si gjyqtare porote, të shikohet mundësia e zëvendësimit të zyrtarit ligjor (familjarit tuaj), i cili punon në zyrën e kryetarit të trupit gjykues me ndonjë zyrtar tjetër. Në këto raste edhe do të shmangej çdo dyshim apo perceptim negativ i palëve apo publikut në lidhje me objektivitetin dhe paanësinë tuaj si gjyqtare porote.

Sidoqoftë, KKEGJ e vlerëson lartë kontributin tuaj profesional për çështjet e ngritura, si dhe ju inkurajon juve dhe gjyqtarët e tjerë që për të gjitha dilemat rreth shkeljeve të mundshme, ti drejtoheni Komitetit.

Me respekt,